



Tiranë më

Nr.

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**RREGULLAT E SJELLJES SË INSTITUCIONEVE PUBLIKE NË ZGJEDHJE DHE**  
**NDALIMIN E KEQPËRDORIMIT TË ASETVE PUBLIKE**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, 12 agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektvendimi “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”, i cili ka për qëllim marrjen e masave, monitorimin dhe parandalimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, si dhe gjatë fushatës zgjedhore me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.

Hartimi i këtij akti vjen si nevojë dhe reflektim i problematikave që janë vëzhguar përgjatë zgjedhjeve të kryera në vend. Ky akt synon përmirësimin dhe adresimin e të gjitha shqetësimeve apo problematikave të hasura deri më sot nga zbatimi i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të

*ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, si dhe të qartësojë përcaktimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor lidhur me përdorimin e burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore.*

Gjithashtu, shqyrtimi i kërkesave të Komisionerit në KAS ka evidentuar nevojën urgjente për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, sa i takon përkufizimit më të plotë e më të saktë të veprimtarive të ndaluara dhe të atyre të ndaluara për t’u promovuar, si dhe nevojën për rishikimin e masës së gjobës të përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe diversifikimin e saj më të saktë.

Akti është hartuar në 3 (tre) krerë, ku në kreun I përcaktohet qëllimi, përkufizime dhe rregulla të përgjithshme; Kreu II parashikon kategoritë e ndalimeve; dhe Kreu III përcakton dispozitat e fundit.

Subjekte të këtij vendimi janë institucionet publike dhe administrata shtetërore.

Veprimtari publike janë të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe/ose të medias, ose pasqyrohen nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit dhe të informimit publik, si të tilla por pa u kufizuar, media online, rrjete sociale, faqe interneti, etj, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim. Janë gjithashtu veprimtari të tilla dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve; Ndërsa veprimtari e ndaluar është çdo veprimtari apo akt i institucionit publik dhe/ose i administratës shtetërore e cila keqpërdor asetet publike dhe ndalohet për t’u kryer.

Asetet publike përfshijnë burimet njerëzore, financiare, materiale dhe logjistike, si dhe çdo aset tjetër të luajtshëm ose të paluajtshëm sipas përcaktimve të nenit 142 të Kodit Civil, në pronësi dhe/ose administrim të institucioneve publike dhe të administratës shtetërore.

Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, deputeti që i përket mazhorancës qeverisëse, kryetari i bashkisë dhe zëvendësit e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, ose ministrit, së bashku me zëvendësit e tij, drejtori i përgjithshëm dhe zëvendësit e tij për shoqëritë tregtare në të cilat shteti ka më shumë e 50% të aksioneve, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore gjatë periudhës kohore 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo në çfarëdo lloj forme të kontribuojnë në veprimtari dhe/ose aktivitete publike me qëllim paraqitjen publike dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve të bëra nga buxheti i shtetit ose me kredi/donacione të marra nga shteti shqiptar, sipas përcaktimeve për veprimtari të ndaluar. Veprimtaria e ndaluar nuk mund të zhvillohet.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”

**Pavlina DOÇAJ**

- Drejtorja e Ligjshmërisë

**Majlinda ÇELMETA**

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

**PËR RREGULLAT E SJELLJES SË INSTITUCIONEVE PUBLIKE NË ZGJEDHJE  
DHE NDALIMIN E KEQPËRDORIMIT TË ASETETEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “c”, dhe nenit 91 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

KREU I

**QËLLIMI, PËRKUFIZIME DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

**I.1. Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij vendimi është marrja e masave, monitorimi dhe parandalimi i veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe të administratës shtetërore gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, si dhe gjatë fushatës zgjedhore, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.
2. Subjekte të këtij vendimi janë institucionet publike dhe administrata shtetërore sipas përkufizimeve në këtë vendim.

**I.2. Përkufizime**

1. “*Institucion publik*” është çdo organ apo ent publik në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.
2. “*Administratë shtetërore*” është:

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



“Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të asetëve publike”

- a) administrata nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas nenit 1 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përfshihen institucionet e përmendura në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji.
  - b) punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre, janë nëpunës civilë dhe punonjës administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë civilë, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;
  - c) punonjës policie, punonjës të shërbimit të jashtëm, të përmendur në nenin 3 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elemente të tjera rregullohen me ligje të posaçme, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.
3. “*Institucion publik*” konsiderohet çdo organ apo ent publik në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

“*Veprimtari publike*” janë të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe/ose të medias, ose pasqyrohen nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit dhe të informimit publik, si të tilla, por pa u kufizuar, media online, rrjete sociale, faqe interneti, etj., të kryera, brenda ose jashtë vendit, nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim dhe që raportohen sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative të KQZ-së. Janë gjithashtu veprimtari të tilla edhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katërmujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

“*Veprimtari e ndaluar*” është çdo veprimtari apo akt i institucionit publik dhe/ose i administratës shtetërore, e cila keqpërdor asetet publike dhe ndalohet për t’u kryer.

4. “*Aset publik*” janë burimet njerëzore, financiare, materiale dhe logjistike, si dhe çdo aset tjetër i luajtshëm ose i paluajtshëm sipas përcaktimeve të nenit 142 të Kodit Civil, në pronësi dhe/ose administrim të institucioneve publike dhe të administratës shtetërore.
5. “*Kodi Zgjedhor*” është ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
6. “*KQZ*” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
7. “*KSHZ*” është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
8. “*NRF*” është ndërfaqja elektronike e raportimeve të institucioneve publike, e cila ndërtohet dhe shërben sipas përcaktimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.
9. “*Personi përgjegjës për raportimin*” është Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, sekretari i përgjithshëm i ministrisë, nëpunësi me hierarkinë më të lartë në bashki, drejtori i përgjithshëm apo drejtuesi më i lartë administrativ për agjencitë dhe institucionet nën varësinë e Kryeministrit dhe të ministrave, drejtuesi ekzekutiv i shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në më shumë se 50 për qind të aksioneve, drejtuesi ekzekutiv i ndërmarrjeve shtetërore.
10. “*Raportim*” është veprimi i informimit të KQZ nga institucioni publik për veprimtarinë publike të këtij të fundit.
11. “*Llogari zyrtare në rrjetet sociale*” është adresa e hapur në rrjetet sociale në kuadër të detyrës funksionale që kryhet nga funksionari publik, tregon funksionin dhe përdorimi/përditësimi i tyre bëhet nga strukturat përkatëse për median dhe informim pranë këtij institucioni. Nuk përfshihen në këtë përkufizim llogaritë personale dhe adresat në

rrjetet sociale, të cilat përmbajnë vetëm emrin dhe mbiemrin e funksionarit publik dhe nuk lidhen me funksionin publik të tij.

### **I.3. Rregulla të përgjithshme**

1. Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, deputeti që i përket mazhorancës qeverisëse, kryetari i bashkisë dhe zëvendësit e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit ose ministrit, së bashku me zëvendësit e tij, drejtori i përgjithshëm dhe zëvendësit e tij për shoqëritë tregtare në të cilat shteti ka më shumë se 50% të aksioneve, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore gjatë periudhës kohore 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo në çfarëdo lloj forme të kontribuojnë në veprimtari dhe/ose aktivitete publike me qëllim paraqitjen publike dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve të bëra nga buxheti i shtetit ose me kredi/donacione të marra nga shteti shqiptar, sipas përcaktimeve për veprimtari të ndaluar parashikuar në këtë vendim.
2. Veprimtaria e ndaluar nuk mund të zhvillohet.
3. Personi përgjegjës për raportimin ka detyrimin për raportimin e veprimtarive dhe akteve, të cilat mund të përbëjnë veprimtari të ndaluar.

## **KREU II**

### **KATEGORITË E NDALIMEVE**

#### **II.1. Ndalime për miratimin e akteve juridike**

1. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore apo kur akti nënligjor nxirret në zbatim të afateve të detyrimeve ligjore dhe kur fondet janë të parashikuara përpara afatit të ndaluar, sipas këtij vendimi.
2. Kryetari i Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe Kryetari i Këshillit të Bashkisë marrin masa për të mosvendosur, ose propozojnë të mos vendosen në rend të ditës të institucioneve respektive për shqyrtim dhe miratim akte të përmendura në pikën II.1.1 të këtij kreu.

#### **II.2. Ndalime për promovimin e veprimtarive publike**

1. Janë të ndaluara veprimtaritë publike me karakter politik të institucioneve publike për:
  - a) promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut.
  - b) promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut.

- c) promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve për mbrojtjen e monumenteve dhe objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor ose për mbrojtjen e objekteve të luajtshme me vlerë historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore.
  - ç) promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.
  - d) shpërndarjen në aktivitet publik të lejeve të legalizimeve;
  - dh) shpërndarjen e akteve për regjistrimin e tokës bujqësore apo çdo lloj pronësie tjetër sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit “Për kadastrën”.
  - e) promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.
2. “Veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” janë edhe veprimtaritë publike të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit sipas përkufizimit të nenit I.2, pika 3, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishitazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë, por pa u kufizuar, si përdorimin e fondeve publike për mbështetje të subjekteve zgjedhore, vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor të institucioneve.
  3. Ndalimet e mësipërme nuk përfshijnë përmbushjen e përgjegjësive ligjore, si dhe ushtrimin e detyrave funksionale të institucioneve publike dhe të funksionarëve përkatës.

### **II.3. Ndalime të përdorimit të aseteve**

1. Ndalohet vënia direkt ose indirekt në dispozicion të partive politike dhe/ose subjekteve zgjedhore të mjeteve materiale dhe monetare në pronësi, apo në administrim të institucionit publik.
2. Në përputhje me fushën e përgjegjësisë, funksionari i institucionit publik mund të zhvillojë veprimtari publike si të tilla, por pa u kufizuar, si: inspektime, takime, konsultime publike, prezantime të projekteve me interes komunitar, etj., me kushtin që pjesëmarrës në to të jenë vetëm persona të cilët janë pjesë e stafit të institucionit publik përkatës, apo që qartazi kanë lidhje përgjegjësie ose bartin të drejta dhe detyrime me dhe nga veprimtaria. Por ndalohet me këtë rast pjesëmarrja në aktivitet e përfaqësuesve politikë, deputetëve që nuk i përkasin zonës zgjedhore ku zhvillohet veprimtaria, si dhe promovimi politik dhe elektoral në çdo formë, direkt apo indirekt.
3. Në zhvillimin e një veprimtarie partiake, në të cilën promovohet një punë publike apo një projekt i caktuar, ndalohet përdorimi i shenjave dhe simboleve të institucioneve publike.
4. Në zhvillimin e një veprimtarie partiake ose elektorale ndalohet përdorimi në çdo formë i automjeteve të institucioneve publike, me përjashtim të rastit kur përdorimi i tyre lidhet me ruajtjen dhe sigurinë personale fizike të funksionarit publik për shkak të statusit të këtij të fundit.

### **II.4. Ndalime të sjelljes së administratës shtetërore**

1. Ndalohet përfshirja e detyruar e administratës shtetërore në fushatë zgjedhore.
2. Punonjësit të administratës shtetërore gjatë periudhës zgjedhore i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe

- ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi dhe në këtë vendim.
3. Punonjësi i administratës shtetërore, i cili është regjistruar si kandidat për zgjedhjet, pezullohet nga detyra nga momenti i regjistrimit të tij si kandidat deri në datën e përfundimit të numërimit të votave në zonën ku kandidon. Për nëpunësit, marrëdhënia e punës të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, merren masa, sipas rastit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës apo pezullimin nga detyra në rastet kur rezultojnë që janë regjistruar si kandidatë për zgjedhje.
  4. Punonjësit të administratës shtetërore gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin, veprimtarinë shtetërore, burimet financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje.
  5. Punonjësi i administratës shtetërore vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Në këtë rast nëpunësit civil gjatë pjesëmarrjes në këto veprimtari i ndalohet të manifestojë me pankarta dhe/ose parulla të ekspozuara publikisht, apo të jetë protagonist në veprimtaritë politike të subjektit zgjedhor ose kandidatit.
  6. Punonjësit të Gardës së Republikës gjatë dhe pas orarit të punës/shërbimit i ndalohet të sillet dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës, si dhe të marrë pjesë në veprimtari të partive politike ose të shoqatave/organizatave me karakter politik.
  7. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit gjatë dhe pas orarit të punës/shërbimit i ndalohet të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit, si dhe të marrë pjesë në veprimtari të partive politike ose të shoqatave/organizatave me karakter politik.
  8. Ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura gjatë dhe pas orarit të punës/shërbimit i ndalohet të marrë pjesë në veprimtari të partive politike ose të shoqatave/organizatave me karakter politik.

## **II.5. Rregulla të përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online**

1. Funkionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt apo indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjete sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete.
2. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive të ndaluara në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të funksionarit publik.
3. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, postimi i mesazheve elektorale në faqet zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të vetë funksionarit publik.

## **II.6. Masa organizative për zbatimin e ndalimeve**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive, kryetarët e bashkive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë:
  - a) organizojnë menjëherë punën për zbatimin e detyrimeve ligjore për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale,

- mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e administratës shtetërore, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore të çdo niveli.
- b) kontrollojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e nëpunësve dhe punonjësve nën varësinë e drejtëpërdrejtë të tyre, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
  - c) jo më vonë se katër muaj para datës së zgjedhjeve publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare të internetit, duke kërkuar denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
  - ç) kërkojnë informacion periodik mbi të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale.
  - d) informojnë të gjithë punonjësit në varësi që automjetet, si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo institucionit, ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje. Bën përjashtim nga ky ndalim përdorimi i automjeteve nga të gjitha institucionet në përmbushje të detyrave të tyre funksionale.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive, kryetarët e bashkive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë, në rastet e verifikimit të ndalimeve në këtë akt, duhet të informojnë menjëherë KQZ-në.

### **KREU III DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **III.1. Shfuqizime dhe hyrja në fuqi**

1. Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, me përjashtim të neneve 1/1, 4, 5 dhe 9, shfuqizohet.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.
4. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi të gjitha institucionet dhe entet publike, sipas përkufizimeve në këtë vendim.